



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1014/4 Prot.

Tiranë, më __. __. 2018

V E N D I M

Nr. 176 , Datë 13 / 09 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën me nr.105 Regj., datë 16.07.2018, të z.S. Z, kundër Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Dega Rajonale Gjirokaštër (ISHMPU Gjirokaštër) dhe Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave Tiranë (ISHMPU), me pretendimin për diskriminim për shkak të “*bindjeve politike*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Subjekti ankues, z.S. Z ka lidhur marrëdhëniet e punës me institucionin e ISHMPU Gjirokaštër, me datë 21.02.2014. Me Urdhërin nr.591, datë 21.02.2014 është emëruar Inspektor në Sektorin e Policisë Pyjore pranë ISHMPU Gjirokaštër. Ankuesi informon Komisionerin se me datë 20.04.2018 ka qenë i pranishëm në vendin e quajtur Ura e Viroit, në aksionin e ndërmarrë nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit (MMT) “Pastrojmë Tokën që duam”. Z.Z shprehet se me Urdhërin nr.210, datë 11.05.2018 të Kryeinspektorit të ISHMPU Gjirokaštër, z.S. R i është komunikuar masa disiplinore “Vërejtje” për abandonim të këtij aksioni; ndërkohë që në komunikimin zyrtar me ISHMPU Qendrore, Kryeinspektorit z.L i bëhet me dije nga vetë z.R se me datë 20.04.2018, në zbatim të aksionit të ndërmarrë nga MMT, ishte kryer me sukses pastrimi në vendin e quajtur Ura e Viroit. Ndër të tjera citohet shprehimisht se: “...U krye pastrimi në 2 km

¹ Subjekti ankues provon anëtarësinë e tij në forcën politike të subjektit politik, Partia “Lëvizja Socialiste për Integrim”, me kartën e anëtarësisë me nr.17449 /Njësia Libohovë.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën: KMD.

gjatësi lineare, si dhe, papastërtitë brenda në ujë u hoqën nga punonjësit e ISHMPU me kostum anti uji....”.

Ankuesi thekson faktin se masa disiplinore u ndërmorën jo vetëm për atë personalisht, por dhe për 9 inspektorë të ISHMPU Gjirokastrë, kolegë të tij. Po ashtu, ai me datë 15.05.2018 e ka kundërshtuar këtë masë disiplinore si të padrejtë dhe të qëllimshme, por që nuk ka marrë asnjë përgjigje nga ana e ISHMPU Gjirokastrë.

Ndërkaq, tendenca ndaj tij është përforcuar me propozimin e Kryeinspektorit të ISHMPU Gjirokastrë për largimin e tij nga puna³. Me shkresën me nr.3549 prot., datë 10.07.2018 ankuesi është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ISHMPU Gjirokastrë.

Z.Z shpreh bindjen se të gjitha veprimet dhe masat disiplinore në dëm të tij janë ndërmarrë vetëm për shkak se ai është anëtar i subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, pra për shkak të bindjeve të tij politike.

Në përfundim të ankesës së tij, z.Z kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të tij nga ana e punëdhënësit, dhe rregullimin e pasojave.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.*

Shkaku sipërcituar përbën shkak të mbrojtur nga ligji 10 221/2010, neni 1 dhe neni 3/1, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku parashikohet se *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që*

³ Shkresa me nr.58 prot., datë 03.07.2018 e ISHMPU Gjirokastrë.

⁴ Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi".

Në nenin 12, "**Ndalimi i diskriminimit**", pika 1, parashikon se: "*Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës.*"

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

- Me shkresën me nr.1014/1 prot., datë 20.02.2018 Komisioneri i ka kërkuar informacion dhe dokumentacion provues ISHMPU Gjirokastër dhe ISHMPU Tiranë, lidhur me pretendimin e z.Z.

Me shkresën me nr.3804/1 prot., datë 13.08.2018 ISHMPU Tiranë ka sqaruar Komisionerin lidhur me pretendimin e z.Z, si dhe ka theksuar faktin se që me datë 25.05.2018, me shkresën me nr.2192/1 prot., të po kësaj date, të Kryeinspektorit të ISHMPU Tiranë, është anuluar procedura për zgjidhjen e marrëdhënies së punës për punonjës S. Z, pasi propozimi për largimin e tij nga puna është i pabazuar në prova dhe fakte, për pretendimet e ngritura nga ana e drejtuesit të ISHMPU Gjirokastër.

Nga ana tjetër, vetë subjekti ankues, nëpërmjet e-mailit të tij dërguar KMD-së⁵, ka kërkuar ndërprerjen e procedurës hetimore nga ana e Komisionerit, për shkak se ai vijon të jetë i punësuar pranë ISHMPU Gjirokastër (është pezulluar procedura për largimin e tij nga puna) dhe konsideron të përmbushur qëllimin për të cilin kishte iniciuar ankesën.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se është arritur qëllimi për të cilin dhe kishte iniciuar ankesa.

⁵ Adresa e e-mailit të ankuesit: mz@gmail.com

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), c), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe nenin 94, pika 1 e Kodit të Procedurës Administrative,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Ndërprerjen e procedurave të hetimit dhe pushimin e shqyrtimit të ankesës së z.S. Z kundër ISHMPU Gjirokastrë dhe ISHMPU Tiranë, pasi u arrit qëllimi për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Fusha: Punësim
Shkaku: Bindjet politike